



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

BISEDIME PËRFUNDIMTARE

“Në lidhje me çështjen (JR) Nr. 7/2023, datë 14.02.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka)”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Bisedime përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **zj. Armida Hamiti (Moçka)**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 11.7.2025

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

E nderuar zj. kryesuese e Trupit Gjykses!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqsor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqsor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në mënyrë të përmbledhur vlerëson si vijon:

I. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka) ka deklaruar interesat privatë dhe pasurorë fillimisht në “Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës”, dorëzuar në ILDKPKI, datë 14.12.2011, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011 - 2016 dhe në Deklaratën “Vetting” dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017.

1.1 Sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankimin e datës 3.2.2023 dhe parashtrimet në seancën e datës 4.7.2025, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që në deklaratën e parë para fillimit të detyrës, pasuritë:

- (i) *Akti i marrjes së tokës në përdorim, nr. regj akti ***, datë **.10.1994, bashkëpronësi, 5.000 m², Mifol;*
- (ii) *Akti i marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, datë ***.3.1993, me sipërfaqe 18.619 m,² bashkëpronësi, 18.619 m², Mifol;*
- (iii) *Shpronësim nga rruga Levan-Vlorë. Vlera 710.000 lekë të reja;*
- (iv) *Apartament banimi, kontrata e porosisë datë 4.5.2011, 116 m², Lagjja “****”, Vlorë. Vlera 50.000 euro.*

1.2 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*”, subjekti, përveç të ardhurave nga paga në Shkollën e Magjistraturës, ka deklaruar: *të ardhura nga aktivitet privat i familjes bujqësore, ullishte, vreshtari, bujqësi, në vlerën 53.000 euro.* Sikundër ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka investuar shuma të ndryshme në formën e depozitave bankare, për periudhën duke nisur nga data ***.8.2011 deri në datë ***.12.2015, në shumën totale prej 50.000 euro.

1.3 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: (i) Më datë ****.9.2012, Kontratë shitje për blerje garazh, nr. rep.***, nr. kol **/**, sipërfaqe 23,4 m², me të ardhura nga puna dhe aktivitet privat. Vlera 500.000 lekë; (ii) Më datë ****.12.2012, Blerje automjeti tip “Peugeot” (viti 2000) nga shtetasja**** ***, banuese në Fier, me të ardhura nga puna. Vlera 100.000 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar pjesë takuese.

2. Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012-2015, subjekti në rubrikën: “*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtarinë publike dhe/ose private*”, ka deklaruar interesat e përfituara nga depozitat bankare për secilin vit, dhe në DV-2015, ka deklaruar veprimet e kryera për mbylljen e depozitave dhe transferimin e tyre në **** ** Bank, në emrin e nënës së saj.

3. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ky i fundit administroi në cilësinë e provës një pjesë të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në funksion të shkaqeve të ankimit, për të cilat u konkludua se ishin paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, respektivisht:

- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ****.9.2023, redaktuar jashtë, me palë shitëse ****.***., *.*.*, **.***. dhe palë blerëse znj.*** ** (motra e subjektit të rivlerësimit);
- Kontratë kredie hipotekore pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2023, redaktuar jashtë, lidhur midis bankës “**** ****” Spa, në cilësinë e “huadhënësit” dhe znj. *** ** në cilësinë e “huamarrëses”;
- Vërtetim nr. *** prot., datë **.6.2025, lëshuar nga Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë;
- Shkresa “Kthim përgjigje” nr. ***/** prot., datë **.6.2025, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë;
- Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ****.6.2025, me deklarues **** **;
- Deklarata noteriale “Pranim Dhurimi” nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025 me deklaruese Sonila Moçka;
- Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025 me deklarues **** **;
- Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025, me deklarues **** **;

4. Gjatë paraqitjes së parashtrimeve dhe debatit gjyqësor në seancën e datës 4.7.2025 në Kolegj, subjekti i rivlerësimit lidhur me burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara në deklaratën e parë para fillimit të detyrës, mbajti të njëjtin qëndrim sikurse dhe në

Komision, duke sjellë të njëjtat argumenta për sa i takon të ardhurave të familjes së origjinës nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral ndër vite. Në funksion të shkaqeve të ankimit, subjekti paraqiti dhe akte mbi destinacionin e shumës 50.000 euro, shumë e cila ishte depozituar dhe administruar në llogari bankare të subjektit deri në vitin 2015, moment kur i është transferuar nëpërmjet transaksioneve bankare znj.*** ***, (nëna e subjektit të rivlerësimit).

5. Në përfundim të këtij gjykimi, pasi u vlerësuan aktet e depozituara në funksion të shkaqeve të ankimit, në raport me parashtrimet e subjektit gjatë seancës në Kolegj, për sa i takon shkaqeve të ankimit mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti si rezultat i aktivitetit të familjes bujqësore, të cilat janë deklaruar si burim për krijimin e pasurive në emër të subjektit të rivlerësimit, parë kjo në raport me detyrimin që kanë subjektet e rivlerësimit për të justifikuar burimet e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë, konstatojmë sa vijon:

5.1 Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës 2009-2011, në datën 16.11.2011 është emëruar Prokurore në stazh pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nga muaji tetor 2012 dhe deri në tetor 2015 ka ushtruar funksionin e Prokurores pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5.2 Sikundër ka rezultuar nga aktet në dosje, pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2011, rezultojnë të krijuara dhe të materializuara në formën e pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme (pjesërisht), që në deklarimin e saj të parë si prokurore stazhiere, që i përkon kohës përpara fillimit të detyrës.

5.3 Subjekti i rivlerësimit, si gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, ka qenë konsistente në deklaratimet e saj lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive dhe pjesën takuese të tyre;

5.4 Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në funksion të pretendimeve të saj mbi ekonominë e familjes bujqësore, si dhe realizimit dhe administrimit të të ardhurave në kuadër të ekonomisë familjare nga aktiviteti i bujqësisë dhe ai blegtoral, subjekti i rivlerësimit parashtrroi gjithashtu edhe se shuma 50.000 euro, e cila deri në vitin 2015 administrohej në formën e depozitave bankare nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe në vitin 2015 e gjithë kjo shumë është transferuar në emër të nënës së subjektit, aktualisht rezulton e dhuruar motrës së subjektit të rivlerësimit, znj.**.**..

5.4.1 Në përputhje me parashtrimet e saj, subjekti depozitoi në cilësinë e provës deklaratat noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025; nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025; dhe atë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2025, respektivisht të të atit, të motrës dhe të vëllait, të cilët konfirmojnë transferimin dhe dhurimin e shumës 50.000 euro në emër të motrës të subjektit të rivlerësimit znj. **.**. Në funksion të këtyre deklarimeve dhe parashtrimeve të saj, subjekti depozitoi në cilësinë e provës edhe: *Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol. datë **.9.2023; Kontratë kredie hipotekare nr. *** rep., nr. *** kol. datë **.9.2023¹*, akte në të cilat paraqitet e motra e subjektit të rivlerësimit, znj. **.**, në cilësinë e palës blerëse të një pasurie të paluajtshme në shtetin italian dhe kredimarrëse në një bankë po në shtetin italian.

5.5 Sikundër trajtuar dhe në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 4.7.2025, nga aktet e depozituara në dosje ka rezultuar se është konfirmuar pronësia e babait të subjektit të rivlerësimit, të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokës bujqësore, një pjesë e së cilës dhe është shpronësuar me VKM-në² përkatëse dhe për të cilën babai i subjektit është kompesuar në mjete monetare.

5.6 Subjekti i rivlerësimit, ka depozituar gjatë hetimit në Komision akte mbi pagesën e kontributeve nga nëna e saj, znj. *** Moçka, e cila rezulton se që nga viti 1991, derdh kontribute si e vetëpunësuar në bujqësi.

5.7 Aktiviteti i vazhdueshëm bujqësor i prindërve, përveçse nga aktet në dosje të Komisionit, si mandat pagesa të ndryshme që referojnë shpenzime të kryera në funksion të prodhimit ndër vite, apo dhe konfirmime zyrtare të institucioneve respektive, konfirmohet edhe nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rishtazi, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, konkretisht: shkresë e Njesisë Administrative Novoselë, Drejtoria e Pronave Publike, nr. *** prot., datë **.6.2025; dhe shkresë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, nr. ***/* prot., datë **.6.2025, të cilat rikonfirmojnë regjistrimin e babait të subjektit si fermer me status ligjor “*prodhues bujqësor*”, *aktiv deri në momentin e përpilimit të akteve si mësipër*; pagesën e taksës së tokës bujqësore për sipërfaqet bujqësore në pronësi si dhe ushtrimin, në mënyrë të rregullt, të veprimtarisë bujqësore në fushën e ullishtarisë dhe përfitimin e të ardhurave nga kultivimi dhe shitja e produkteve të ullirit, referuar të dhënave të Zyrës së Bujqësisë pranë Njesisë Administrative Novoselë.

¹ Aktet e mësipërme janë depozituar në fotokopje të njësuar me origjinalin, të përkthyer dhe apostiluar, në gjuhën shqipe.

² VKM nr.482, datë 23.6.2010 “Për Disa Ndryshime Në Vendimin Nr.207, Datë 21.2.2008 Të Këshillit Të Ministrave “Për Shpronësimin Për Interes Publik, Të Pronarëve Të Pasurive Të Paluajtshme, Pronë Private, Të Cilët Preken Nga Ndërtimi I Segmentit Rrugor Levan-Vlorë (Seksioni I Dytë)”, Të Ndryshuar.

5.8 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se edhe pse në përfundim të hetimit administrativ mbeti i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në cilësinë e pjesëtares së familjes bujqësore, ajo zotëron vetëm 20% të titullit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme (i) “*apartament banimi me sipërfaqe 116 m²*” dhe (ii) “*garazh me sipërfaqe 23,04 m²*”, me adresë në lagjen “****”, Vlorë, rrethanat e rezultuara në përfundim të këtij gjykimi, lexuar në harmoni dhe me parashtrimet dhe provat e depozituara rishtazi nga subjekti i rivlerësimit, vlerësohen bindëse.

5.9 Ky vlerësim i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mbështetet edhe në sa qartësuar gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, nga përgjigjet e vetë subjektit të rivlerësimit ndaj pyetjeve të drejtuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme lidhur me shkaqet e ankimit në raport me situatën faktike të konstatuar.

5.10 Rrethanat e rezultuara, duhet të vlerësohen në harmoni edhe me rrethanat e provuara gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, kur ky i fundit, nuk ka konstatuar problematika, që lidhen me dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, atë të vlerësimit të aftësive profesionale³, si dhe të kontrollit të figurës, duke arritur nivel të besueshëm.

5.11 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson të theksojë se, situatat për të cilat subjekti do të ngarkohej me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në raport dhe me sa parashtruar nga vetë subjekti në seancën e datës 4.7.2025, lidhen me mungesën e plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për të ardhura të familjes së origjinës dhe pasuri të krijuara përpara fillimit të detyrës.

5.11.1 Në vlerësim të situatës faktike, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 20/2024, mban në konsideratë rrethanat si mëposhtë:

- (i) Pasuria apartament banimi në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting, rezulton se është fituar nëpërmjet kontratës së porosisë nënshkruar midis palëve datë 4.5.2011, kontratë sipas së cilës rezulton të jenë shlyer dhe pagesat për këtë pasuri, si dhe kontratës përfundimtare të shitjes datë 10.9.2012. Subjekti i rivlerësimit ka filluar të ushtrojë funksionet e prokurorit në tetor të vitit 2011, si prokurore në stazh dhe është emëruar në detyrë duke filluar nga muaji tetor 2012. Ky fakt përjashton tej çdo dyshimi se subjekti ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e saj, në

³ Për subjektin e rivlerësimit në dosjen e Komisionit, rezulton se është paraqitur vetëm një denoncim për gjithë periudhën e ushtrimit të funksionit të saj si prokurore që prej emërimit të saj në vitin 2012, denoncim i vitit 2019 për të cilin subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime ezauresive gjatë hetimit administrativ.

krijimin e pasurive të deklaraura, në përputhje me qëllimin e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që synojnë nxjerrjen nga sistemi të individëve që kanë abuzuar me detyrën për përfitimet e tyre personale⁴.

- (ii) Është e provuar pronësia e një sipërfaqeje të konsiderueshme toke bujqësore në emër të prindërve të subjektit (konkretisht babait);
- (iii) Konfirmohet nga institucionet shtetërore përgjegjëse, ushtrimi i aktivitetit të vazhdueshëm në tokat bujqësore dhe aktivitetit blegtorial, nga ana e prindërve, dhe babai i subjektit të rivlerësimit vazhdon të ushtrojë aktivitetin i regjistruar si fermer, duke vazhduar kultivimin e kulturave bujqësore dhe gjenerimin e të ardhurave;
- (iv) Gjatë hetimit administrativ të Komisionit nuk u konstatua asnjë rrethanë që të tregojë se të ardhurat e deklaruarat të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, të vinin nga një aktivitet i paligjshëm;
- (v) Nëna e subjektit ka vazhduar të krijojë të ardhura, të cilat duket se i ka depozituar në sistemin bankar⁵, konfirmuar nga bankat e nivelit të dytë në kuadër të hetimit nga Komisioni;
- (vi) Në vijim të pretendimit të subjektit se ka vepruar në cilësinë e përfaqësueses së familjes bujqësore, sikundër trajtuar dhe në ankim, ka rezultuar se depozita prej 50.000 euro, fillimisht në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në tërësi i është transferuar nënës së saj në vitin 2015. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti në parashtrimet e saj deklaroi dhe dokumentoi dhurimin e shumë 50.000 euro, të disponuar në llogarinë bankare të nënës së saj, një tjetër pjesëtar i familjes bujqësore, motrës së subjektit të rivlerësimit;
- (vii) Subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistente dhe koherente në deklarin e burimeve të krijimit të pasurive, si në deklaratat periodike vjetore depozituar në ILDKPKI, të cilat referuar nenit 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016 kanë vlerën e provës dhe në Deklaratën Vetting, ashtu dhe në deklarinet e saj përgjatë hetimit administrativ të Komisionit si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj;
- (viii) Për subjektin e rivlerësimit nuk ekziston asnjë indicie apo e dhënë nga burime të tjera, lidhur me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e kriterit të figurës dhe atij profesional, që të bëjnë të cënueshëm vendimin e Komisionit;

⁴ Referohu jurisprudencës së Kolegjit, vendimi JR nr. 20/2023.

⁵ Sipas konfirmimit të “***” Bank me shkresën nr. **/*** /* prot., datë **.8.2020.

5.12 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të rrethanave të sipër cituara në raport me shkaqet e ankimit, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se për shkak të specifikave të këtij rasti, që lidhen me momentin e krijimit/materializimit të pasurive në emër të subjektit, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e prokurorit apo në ndonjë funksion tjetër publik në kohën e krijimit të tyre, vlerësohet se nuk ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit të detyrës së saj, në krijimin e pasurive të deklaruar. Gjithashtu, nisur nga fakti se gjatë hetimit në Komision dhe shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk ka rezultuar ndonjë indicie apo e dhënë nga burime të tjera, lidhur me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, *vlerësojmë* se problematikat e konstatuara nuk janë të tilla që të justifikojnë sanksionin disiplinor të tillë si shkarkimi nga detyra e subjektit të rivlerësimit znj. Armida Hamiti (Moçka).

III. KËRKIMI I PËRFUNDIMTAR

6. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përfundim të këtyre bisedimeve, bazuar në dispozitën e pikës 7 nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Armida Hamiti (Moçka)

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Adnan XHOLI